



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.926/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Ferki Xhaferi kryesues, Rustem Thaqi, Faton Ademi anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Lipjanit Armend Grajqevci nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Lipjanit, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.11.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**I. Pranohet** si i bazuar apeli Anr.926/2021 i datës 04.11.2021, i kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Lipjanit, Armend Grajqevci nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Lipjanit, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal,

**II. Urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimin për Kandidat për Kuvend Komunal nga Lidhja Demokratike e Kosovës, në Komunën e Lipjanit, në Vendvotimin: 1328E/03D.

**III. Rezultati** i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutitë në Vendvotimin si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

## A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.926/2021, i paraqitur nga Armend Grajqevci, Kandidat për Kuvend Komunal nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me të cilën pretendon se në vendvotimet nr. 1328E/03D, se ka mos përputhje në mes të formularëve dhe votave që figurojnë në rezultatet e KQZ-së dhe kjo dëshmohet edhe me anë të deklaratave dhe formularëve që janë të bashkangjitura në shkresat e lëndës.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura, në apel në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

## Apeli është i bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se, Kandidati për Kuvend Komunal nga Lidhja Demokratike e Kosovës Armend Grajqevci, kërkon rinumërimin e votave në vendvotimin e lartë cekura, PZAP, pas shqyrtimit të apelit erdhi në përfundim se apeli i ushtruar nga kandidati në fjalë për rinumërimin e votave për vendvotimin e lartcekur është i bazuar.

Paneli vlerëson se apeli është mbështetur në provat e dorëzuara nga kandidati, ku shihet qarte se nga deklaratat e votuesve të bashkangjitura në shkresat e lëndës deklarohet se në vendvotimet 1328E/03D, kanë votuar për kandidatin Armend Grajqevci, me numrin 33, ndërsa në listën e shpallur nga KQZ-ja figurojnë 0 vota.

Andaj ky panel, vlerëson se rinumërimi në këtë vendvotim e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparenca, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës së lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi.

Paneli me qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze*, gjithashtu në mbështetje të nenit 117.4 dhe po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 dhe 120 pika d) të LZP-së, urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimin e lartcekur duke vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr. 926/2021 më datën 06.11.2021.

Kryesues i Panelit

Ferki Xhaferi

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimin të këtij vendimi.

